

## PROTOKOLL

### **Për veprim në Shkollën e mesme ekonomike komunale “Gostivar”-Gostivar gjatë kohës së rregjistrimit të nxënësve në vitin e parë në vitin shkollor 2020/2021**

- Rregjistrimi i nxënësve në vitin e parë në Shkollën e mesme ekonomike komunale “Gostivar”-Gostivar do të realizohet në periudhën prej ora 07:00 deri 19:00
  - Të punësuarit në shkollë detyrimisht të shfrytëzojnë masa mbrojtëse,maska dhe doreza
  - Me vendim të drejtorit të shkollës formohen ekipe me qëllim realizimin e rendit dhe mbajtjen e distancës së nevojshme prej minimum 2 metra, edhe atë nga 2 (dy) persona përgjegjës para, 2 (dy) persona përgjegjës brenda dhe 1 (një) person përgjegjës në dalje të shkollës
  - Gjatë pritjes rradhë të nxënësve para dhe brenda në shkollë vendosen shenja me të cilat do të shënohet drejtimi i lëvizjes dhe ruajtja e distancës së nevojshme
  - Hyrja e shkollës organizohet nga njëra anë,ndërsa dalja nga ana tjetër
  - Organizimi i 3 (tre) vendeve të pranimit në shkollë për pranim të dokumenteve të nevojshme për rregjistrim konform konkursit
  - Lejimi i hyrjes së tre nxënësve në të njëjtën kohë në shkollë konform vendeve të parapara për pranim
  - Lejimi i hyrjes vetëm i nxënësit jo edhe i prindit të tij,në raste të vecanta nëse nxënësi është i penguar nga shkaqe të arsyeshme lejohet vetëm hyrja e 1 (një) prindi/tutori, i cili gjatë hyrjes në shkollë duhet të mbajë maskë mbrojtëse,ose shall me të cilën do të mbulohen goja dhe hunda.
  - Dorëzimi vetëm i dokumenteve të kompletuara konform kushteve të konkursit,të shoqëruara me fletparaqitje paraprake për rregjistrim të plotësuar,e cila merret nga webfaqja e Ministrisë së Arsimit dhe shkencës.
  - Nxënësve/prindërve të cilët nuk kanë mundësi fletparaqitjen për rregjistrim ta marrin nga webfaqja e Ministrisë së Arsimit dhe shkencës, të njëjtën do të ua sigurojë shkolla
  - Para hyrjes në shkollë,brenda në shkollë,në hapësirat ku bëhet rregjistrim dhe në dalje të shkollës do të vendosen mjete për dezinfektim
  - Detyrimisht kryerje e rregullt e dezinfektimit të bankave,hapësirës në shkollë,mirëmbajtja e toaleteve,ndërsa në fund të secilës ditë detyrimisht pastrim mekanik dhe dezinfektim
- ME QËLLIM TË MBROJTJES SË SHËNDETIT,U BËJMË THIRRJE TË GJITHË NXËNËSVE PËR RRESPEKTIM NË PËRPIKSHMËRI TË MASAVE PREVENTIVE NGA QEVERIA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT**
- Bëhuni të durueshëm,pritni në rradhë para shkollës dhe mbani distancë së paku 2 metra prej njerëzve rreth Juve,para dhe në shkollë
  - Rrespektoni udhëzimet e njerëzve përgjegjës,hyni në shkollë një nga një,d.m.th. pasiqë personi përgjegjës do Ju lejoj,gjegjesisht pasi nxënësi para Juve të dal nga shkolla.
  - Mos qëndroni më shumë se 5 deri 10 minuta në shkollë
  - Detyrimisht mbani mjete mbrojtëse,(maskë,shall),në të kundërtën nuk do të ju lejohet hyrja në shkollë..

**JU FALEMINDERIT QË I RRESPEKTONI MASAT,PËR SHKAK SE NËSE MBRONI VETEN TUAJ,I MBRONI EDHE TË TJERËT**

**10.06.2020**

**Shkolla e mesme ekonomike komunale “Gostivar”-Gostivar**